

## RAPORTIM I ZBATIMIT TE BUXHETIT TE VITIT 2018 (JANAR-GUSHT) BASHKIA E SHKODRËS

*Shtator 2018*

I. Buxheti i Bashkisë për Vitin 2018.	3
II. Realizimi i te ardhurave te Bashkisë nga burimet e veta vendore për 8-mujorin 2018.	4
III. Realizimi i buxhetit te 8-mujorit 2018	11
P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim,Administrim)	19
P2.Planifikimi Urban	29
P3.Infrastruktura Rrugore	32
P4. Shërbimet Publike	37
P5. Transporti publik dhe lëvizshmëria	45
P6. Zhvillimi ekonomik lokal	48
P7.Bujqësia,Zhvillimi Rural dhe Trajtimi i AMTP	57
P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave	63
P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi	69
P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale	77
P11. Kultura dhe shërbimet reakreionale	93
P12. Rinia dhe Sportet	100
P13. Emergjencat Civile	105

## I. Buxheti i Bashkisë për Vitin 2018.

Detajimi i buxhetit për vitin 2018 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore“, ligjin 109/2017 date 30.11.2017“ Per buxhetin e vitit 2018 “ miratuar me VKB nr. 85 date 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2018 - 2020 të bashkisë Shkodër”.

Programi Buxhetor Afatmesëm parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qellim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; zgjerimin e linjave të transportit urban të qytetit dhe rrethqytetëse si dhe ndërtimin e terminalit për akomodimin e mjeteve të transportit të udhëtarëve; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimin të biznesit; nxitjen e investimeve në kërkim dhe zhvillim (start up) dhe zhvillimin e SMS-ve ekzistuese; mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, sigurimin e kushteve sa më dinjitoze për fëmijët dhe të rinjtë shkodranë; mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër;

Zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Shkodrën në një qendër të përparuar social – ekonomike. Ky dokument ka përcaktuar 13 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planet Vendore që i mbështesin këto projekte.

**Bashkia Shkoder, administron dhe menaxhon fondet, sipas 13 programeve të miratuara, të listuar me poshtë:**

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrim”.
2. Programi “Planifikimi urban”.
3. Programi “Infrastruktura rrugore”.
4. Programi “Shërbime Publike”.
5. Programi “Transporti publik dhe levizshmeria (mobiliteti)”.
6. Programi “Zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit”.
7. Programi “Bujqësia dhe zhvillimi rural”.
8. Programi “Mjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotave”.
9. Programi “Arsimi parauniversitar dhe edukimi”.
10. Programi “Strehimi dhe Shërbimet sociale”.
11. Programi “Kultura dhe shërbimet rekreative”.
12. Programi “Rinia dhe Sportet”.
13. Programi “ Emergjencat Civile”

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2018, vijnë nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhurat të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen.

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

## II. Realizimi i të ardhurave të Bashkisë nga burimet e veta vendore për 8-mujorin 2018.

Të ardhurat e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat e veta, taksat e ndara, tarifat vendore, të ardhurat të tjera dhe donacionet. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Gjatë 8-mujorit të parë të vitit 2018 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat sipas programit të kryetarit të bashkisë, kryesisht të fokusuar në lehtësimin maksimal fiskal, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, përmisëm duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësi i shlyerjes së pagesave sa më pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objektivat e përcaktuar e të realizuar, dhe që kanë ndikuar në përmirësimin e klimës së biznesit, duke ruajtur e madje duke rezultuar si politika efikase në rritjen e të ardhurave, janë mbajtja e nivele të ulta të taksave, nivel minimal të taksës së ndikimit në infrastrukturë, lehtësimi kryesisht i bizneseve të vogla, mbështetja me tarifa zero për fermerët, tarifa minimale për tregjet dhe ambulancat etj, me rezultat dhenie frymëmarrje financiare biznesit.

Politikat e ngjashme për tu gjendur sa më pranë taksapaguesit nëpërmjet taksave dhe tarifave të ulëta e në harmoni me shërbimin që ofrohet, si psh: dhënia e lehtësive fiskale për shtresat familjare në nevojë, taksa në minimumin e lejuar ligjor për tokën bujqesore, mundësia e arkëtimit në këste dhe pranë njësive administrative ku banojnë etj, janë zbatuar dhe kanë rezultuar të sukseshme jo vetëm për zbutjen e vështirësive ekonomike për shtresa të veçanta të familjeve dhe reduktimin e papunësisë, por edhe për vetë rritjen e të ardhurave nga viti në vit.

Keto politika të lehtësive fiskale kundrejt përmirësimit të shërbimit janë shoqëruar natyrisht me objektivin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave si nga biznesi, ashtu edhe nga taksapaguesi familjar, kundrejt fokusimit për uljen e barrës fiskale nga ana tjetër, vërteton efikasitetin e këtyre politikave, kundrejt rezultatit pozitiv që bashkia ka arritur në rritjen e bazës së taksapaguesve, si familjar, ashtu edhe atij biznes.

Objektiv i rëndësishëm ka qenë përditësimi i vazhdueshëm i regjistrave dhe kapaciteteve fiskale duke përfshirë gjithë territorin e bashkisë. Për këtë arsye, në bashkëpunim me Njësitë Administrative u koordinuan strukturat e konstatimeve në vend të këtyre kapaciteteve, u ushtruan verifikime të vazhdueshme në të gjitha njësitë administrative, duke vijuar me formalizimin e të dhënave me efekt arritjen e rezultate të mira në zërat kryesorë të të ardhurave. Paralelisht janë ndjekur procedurat e njoftimit brenda afatit, me vijim e masave shtrenguese për subjektet debitorë.

Si rezultat i masave të marra, si dhe i sensibilizimit të vazhdueshëm taksapaguesve, të ardhurat janë realizuar duke përmbushur pritshmëritë e planifikuara.

Objekivi për sigurimin dhe rritjen e të ardhurave të realizuara prej 508,709 mijë Lekë, në krahasim me vitin e kaluar 414,924 u plotësua me 93.785 mijë lekë më shumë, ose 23% më shumë se vitin e kaluar.

Gjithashtu përgjatë periudhës është siguruar përafrimi i planit me nivelet e arkëtimeve, duke garantuar kështu të ardhurat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Të ardhurat e veta u realizuan në proces dhe bashkëpunim me gjithë administratën e bashkisë, me Njësitë Administrative, me Institucionet si agjentë tatimorë, institucionet shtetërore etj. Vijimi i këtij procesi bashkëpunues do mundësojë më tej sigurimin e të ardhurave për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, duke realizuar objektivat madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të të gjithë territorit të bashkisë.

#### Kategorizimi i të ardhurave


- Taksat vendore:
  - Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, për ndërtesa, troje dhe toka bujqësore
  - Taksa e ndikimit në infrastrukturë ngandërtimet e reja
  - Taksa e fjetjes në hotel
  - Taksa e tabelës për qëllim reklamimi ose identifikimi
  - Tatim i sheshtuar mbi fitimin, biznesivogë nga 5 milion deri në 8 milion,
- Taksat e ndara
  - Taksa mbikalimin e të drejtës së pronësisë,
  - Taksa vjetore e mjeteve të përdorura,
  - Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare
  - Të ardhura pjesore nga tatimi mbi të ardhurat personale
- Tarifat vendore
  - Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
  - Tarifa për ndriçimin publik
  - Tarifa për gjelbrimin
  - Tarifa të shërbimit administrative të bashkisë Shkodër
  - Tarifa për parkimin e mjeteve e licensuara dhe vendparkime publike
  - Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri
  - Tarifa për zënien e hapësirave publike
  - Tarifa nga Institucionet e arsimit, kulturës, sportit etj.
- Të ardhura të tjera:
  - Të ardhura nga gjoba
  - Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve, zhdëmtime, shitja e mallrave dhe e shërbimeve etj
- Donacione/Sponsorizime

#### Të ardhurat nga burimet e veta vendore të Bashkisë, 8 mujori i vitit 2018


000/lekë

Nr.	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Plan 8-mujor 2018	Realizimi 8-mujori 2018	Realizimi % 8-mujore
1	Të ardhurat nga taksat vendore	214,026	199,162	93%
2	Të ardhurat nga taksat e ndara	51,442	50,587	98%
3	Të ardhurat nga tarifat vendore	224,632	234,822	105%
4	Të ardhura të tjera	10,345	23,381	226%
5	Të ardhura nga donacionet	204	757	371%
	<b>TOTALI</b>	<b>500,649</b>	<b>508,709</b>	<b>102%</b>

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 8/mujorin e parë të vitit 2018 u realizuan në vlerën 508.709 mijë Lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, nga taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat nga tarifat me 46% dhe të ardhurat nga taksat me 39% të totalit.



#### Vijueshmëria e arkëtimeve, sipas muajve



#### Grafiku i fluiditetit paraqet në baze mujore të ardhurat gjatë 8/m të vitit 2018.

Niveli më i lartë i arkëtimit është në muajin Qershor, me afrimin e afatit të shlyerjes së detyrimit nga biznesi, si dhe ndjekjes së masave shtrënguese ndaj subjekteve debitoare.

Falë fokusimit për zgjerim të mëtejshëm të bazës taksapaguese, evidentimit të kapaciteteve, ndjekjes së hapave ligjorë ndaj subjekteve debitoare, etj., të ardhurat kanë ruajtur një nivelet konstant arkëtimeve, duke siguruar kështu fluiditet financiar në ushtrimin e funksioneve të veta të bashkisë.

Bashkia Shkodër, realizimi i të ardhurave Janar - Gusht 2018, krahasimi me planin 8/mujor 2018 dhe realizimin 8/mujori 2017							
	LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan viti 2018	Plani Janar-Gusht 2018	Realizimi Janar-Gusht 2018	Krahasimi në % me planin Gusht 2018	Realizimi Gusht 2017	Krahasimi në % me planin Gusht 2017
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT E VETA</b>	<b>678,761</b>	<b>500,649</b>	<b>508,709</b>	<b>102%</b>	<b>414,924</b>	<b>123%</b>
<b>A.I</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>287,333</b>	<b>214,026</b>	<b>199,162</b>	<b>93%</b>	<b>172,916</b>	<b>115%</b>
<b>I.1</b>	<b>Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV</b>	<b>4,725</b>	<b>2,741</b>	<b>7,156</b>	<b>261%</b>	<b>3,522</b>	<b>203%</b>
<b>I.1.0</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi BV</b>	<b>100</b>	<b>87</b>	<b>270</b>	<b>311%</b>	<b>172</b>	<b>100%</b>
<b>I.2</b>	<b>Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>129,988</b>	<b>103,766</b>	<b>118,489</b>	<b>114%</b>	<b>95,292</b>	<b>124%</b>
<b>I.2.1</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat</b>	<b>97,611</b>	<b>79,946</b>	<b>103,757</b>	<b>130%</b>	<b>82,902</b>	<b>125%</b>
<b>I.2.1.1</b>	<b>Ndërtesa banimi</b>	<b>24,869</b>	<b>16,661</b>	<b>23,220</b>	<b>139%</b>	<b>13,852</b>	<b>168%</b>
<b>I.2.1.2</b>	<b>Ndërtesa të tjera</b>	<b>72,742</b>	<b>63,285</b>	<b>80,537</b>	<b>127%</b>	<b>69,050</b>	<b>117%</b>
<b>I.2.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore</b>	<b>21,736</b>	<b>14,563</b>	<b>2,759</b>	<b>19%</b>	<b>2,351</b>	<b>117%</b>
<b>I.2.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi truallin</b>	<b>10,641</b>	<b>9,257</b>	<b>11,973</b>	<b>129%</b>	<b>10,039</b>	<b>119%</b>
<b>I.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel</b>	<b>11,514</b>	<b>9,556</b>	<b>6,362</b>	<b>67%</b>	<b>8,678</b>	<b>73%</b>
<b>I.4</b>	<b>Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë</b>	<b>124,000</b>	<b>83,080</b>	<b>57,513</b>	<b>69%</b>	<b>51,595</b>	<b>111%</b>
<b>I.5</b>	<b>Të ardhura nga taksa e tabelës</b>	<b>17,006</b>	<b>14,796</b>	<b>9,372</b>	<b>63%</b>	<b>13,657</b>	<b>69%</b>
<b>A.II</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>79,021</b>	<b>51,442</b>	<b>50,587</b>	<b>98%</b>	<b>37,545</b>	<b>135%</b>
<b>II.1</b>	<b>Të ardhura nga taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve</b>	<b>64,860</b>	<b>42,804</b>	<b>43,786</b>	<b>102%</b>	<b>31,544</b>	<b>139%</b>
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë</b>	<b>8,500</b>	<b>4,845</b>	<b>6,769</b>	<b>140%</b>	<b>5,978</b>	<b>113%</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e rentës minerare</b>	<b>61</b>	<b>41</b>	<b>33</b>	<b>80%</b>	<b>24</b>	<b>135%</b>
<b>II.4</b>	<b>Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale</b>	<b>5,600</b>	<b>3,752</b>	<b>0</b>		<b>0</b>	
<b>A.III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>297,236</b>	<b>224,632</b>	<b>234,822</b>	<b>105%</b>	<b>171,391</b>	<b>137%</b>
<b>III.1</b>	<b>Te ardhura nga tarifa e pastrimit, largimit të mbeturinave</b>	<b>166,879</b>	<b>130,525</b>	<b>136,593</b>	<b>105%</b>	<b>97,327</b>	<b>140%</b>
<b>III.1.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje</b>	<b>73,301</b>	<b>49,112</b>	<b>39,915</b>	<b>81%</b>	<b>28,538</b>	<b>140%</b>
<b>III.1.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione</b>	<b>400</b>	<b>348</b>	<b>684</b>	<b>197%</b>	<b>528</b>	<b>130%</b>
<b>III.1.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi</b>	<b>93,178</b>	<b>81,065</b>	<b>95,994</b>	<b>118%</b>	<b>68,262</b>	<b>141%</b>
<b>III.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>34,267</b>	<b>25,454</b>	<b>26,156</b>	<b>103%</b>	<b>21,668</b>	<b>121%</b>
<b>III.2.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje</b>	<b>21,791</b>	<b>14,601</b>	<b>13,192</b>	<b>90%</b>	<b>9,782</b>	<b>135%</b>
<b>III.2.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione</b>	<b>125</b>	<b>108</b>	<b>145</b>	<b>134%</b>	<b>134</b>	<b>108%</b>
<b>III.2.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi</b>	<b>12,351</b>	<b>10,745</b>	<b>12,818</b>	<b>119%</b>	<b>11,752</b>	<b>109%</b>
<b>III.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>	<b>21,509</b>	<b>16,817</b>	<b>19,288</b>	<b>115%</b>	<b>16,372</b>	<b>118%</b>
<b>III.3.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje</b>	<b>9,469</b>	<b>6,343</b>	<b>6,437</b>	<b>101%</b>	<b>5,595</b>	<b>115%</b>
<b>III.3.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione</b>	<b>125</b>	<b>108</b>	<b>145</b>	<b>134%</b>	<b>123</b>	<b>118%</b>
<b>III.3.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi</b>	<b>11,915</b>	<b>10,366</b>	<b>12,706</b>	<b>123%</b>	<b>10,654</b>	<b>119%</b>
<b>III.5</b>	<b>Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ</b>	<b>74,581</b>	<b>51,836</b>	<b>41,068</b>	<b>79%</b>	<b>36,025</b>	<b>114%</b>
<b>III.5.1</b>	<b>Nga tarifa administrative, kontroll territorit, AMTP, etj.</b>	<b>110</b>	<b>73</b>	<b>4,816</b>	<b>6597%</b>	<b>0</b>	<b>100%</b>
<b>III.5.2</b>	<b>Nga tarifa për vulosje veterinerare të bagëtive të therura</b>	<b>110</b>	<b>73</b>	<b>44</b>	<b>60%</b>	<b>45</b>	<b>97%</b>
<b>III.5.3</b>	<b>Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit</b>	<b>1,546</b>	<b>866</b>	<b>687</b>	<b>79%</b>	<b>1,422</b>	<b>48%</b>
<b>III.5.4</b>	<b>Nga tarifa parkimi për mjetet</b>	<b>3,751</b>	<b>1,800</b>	<b>3,090</b>	<b>172%</b>	<b>2,923</b>	<b>106%</b>
<b>III.5.5</b>	<b>Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës</b>	<b>400</b>	<b>400</b>	<b>0</b>		<b>100</b>	
<b>III.5.6</b>	<b>Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.</b>	<b>200</b>	<b>134</b>	<b>4</b>	<b>3%</b>	<b>0</b>	
<b>III.5.7</b>	<b>Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ</b>	<b>1,925</b>	<b>1,290</b>	<b>971</b>	<b>75%</b>	<b>353</b>	<b>275%</b>
<b>III.5.8</b>	<b>Nga tarifa për zënien e hapësirave publike</b>	<b>41,714</b>	<b>33,788</b>	<b>31,454</b>	<b>93%</b>	<b>31,159</b>	<b>101%</b>
<b>III.5.9</b>	<b>Nga linjat ajrore dhe nëntokësore</b>	<b>1,500</b>	<b>1,005</b>	<b>0</b>		<b>0</b>	
<b>III.5.10</b>	<b>Nga dokumentat për tender, ankand etj.</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>33%</b>	<b>24</b>	<b>8%</b>
<b>III.5.11</b>	<b>Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj</b>	<b>23,315</b>	<b>12,401</b>	<b>11,718</b>	<b>94%</b>	<b>10,112</b>	<b>116%</b>
<b>III.5.11.1</b>	<b>Biblioteka "Marin Barleti"</b>	<b>110</b>	<b>73</b>	<b>21</b>	<b>28%</b>	<b>39</b>	<b>53%</b>
<b>III.5.11.1.1</b>	<b>Muzeumet</b>	<b>2,900</b>	<b>1,885</b>	<b>1,828</b>	<b>97%</b>	<b>1,174</b>	<b>156%</b>
<b>III.5.11.1.1.1</b>	<b>Teatri "Migjeni"</b>	<b>3,500</b>	<b>2,345</b>	<b>845</b>	<b>36%</b>	<b>1,061</b>	<b>80%</b>
<b>III.5.11.1.1.1.1</b>	<b>Qendra Kulturore e fëmijëve</b>	<b>155</b>	<b>105</b>	<b>0</b>		<b>101</b>	
<b>III.5.11.1.1.1.1.1</b>	<b>Pallati sportit "Qazim Dervishi"</b>	<b>550</b>	<b>368</b>	<b>157</b>	<b>43%</b>	<b>520</b>	<b>30%</b>
<b>III.5.11.1.1.1.1.1.1</b>	<b>Nga kopshtet</b>	<b>12,300</b>	<b>5,535</b>	<b>5,635</b>	<b>102%</b>	<b>4,434</b>	<b>127%</b>
<b>III.5.11.1.1.1.1.1.1.1</b>	<b>Nga çerdhet</b>	<b>3,800</b>	<b>2,090</b>	<b>3,232</b>	<b>155%</b>	<b>2,783</b>	<b>116%</b>
<b>A.IV</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>14,864</b>	<b>10,345</b>	<b>23,381</b>	<b>226%</b>	<b>22,844</b>	<b>102%</b>
<b>IV.1</b>	<b>Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)</b>	<b>7,099</b>	<b>5,111</b>	<b>15,873</b>	<b>311%</b>	<b>7,957</b>	<b>199%</b>
<b>IV.2</b>	<b>Të ardhura nga dhënia me qira</b>	<b>4,075</b>	<b>2,730</b>	<b>3,823</b>	<b>140%</b>	<b>5,390</b>	<b>71%</b>
<b>IV.3</b>	<b>Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime</b>	<b>50</b>	<b>33</b>	<b>3,453</b>	<b>10463%</b>	<b>4,738</b>	<b>73%</b>
<b>IV.4</b>	<b>Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve</b>	<b>3,140</b>	<b>2,136</b>	<b>0</b>		<b>4,427</b>	
<b>IV.7</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>500</b>	<b>335</b>	<b>232</b>	<b>69%</b>	<b>333</b>	<b>70%</b>
<b>A.V</b>	<b>TË ARDHURA NGA DONACIONET</b>	<b>307</b>	<b>204</b>	<b>757</b>	<b>371%</b>	<b>115</b>	<b>656%</b>

Në krahasim me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit të kaluar, kemi një rritje të konsiderueshme të të ardhurave me +23%, ose +93.785 mijë Lekë.


Zërat kryesore që kanë ndikuar në shtimin e konsiderueshëm të të ardhurave nga viti i kaluar janë nga taksat e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) +23.197 mijë Lekë më shumë, taksa e ndikimit në infrastrukturë +5.918 mijë Lekë, taksat e ndara +13.042 mijë Lekë, tarifa e pastrimit +39.266 mijë Lekë, tarifa e ndriçimit publik +4.488 mijë Lekë, tarifa e gjetjes 2.916 mijë Lekë, gjopa nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit +2.500 mijë Lekë, bileta nga muzeumet +654 mijë Lekë, tarifa shërbimi MKZ +618 mijë Lekë, etj.

Në lidhje me planin 8/mujor të vitit 2018 të ardhurat janë realizuar 102%, ose +8.060 mijë Lekë më shumë.

Zërat kryesorë me tejkalim në krahasim me planin 8/mujor 2018 që janë taksa mbi ndërtesën, taksa e truallit, të ardhura nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, tarifave vendore si pastrimi, ndriçimi dhe gjelbërimi, tarifa e parkimit, dhe të ardhurat e tjera.

Zërat ndikues në memosrealizim janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, si rezultat i numrit të aplikimeve për ndërtime, taksa e hotelit dhe e tabelës si rezultat i shtyrjes së sezonit turistik deri në muajin shtator, si dhe taksa e tokës bujqësore, si rezultat i mungesës së informacionit të plotë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshmeve pasojë vështirësinë e krijimit të regjistrave të saktë që lidhin pronën dhe taksapaguesin taksa e tokës bujqësore vijon të ketë nivele të ulëta arkëtimi.

Grafiku i mëposhtëm paraqet nivelin e realizimit të të ardhurave në lidhje me planin 8/mujor për kategorite e taksave, taksave të ndara, tarifave dhe të ardhurave të tjera në lidhje.






## Realizimi i të ardhurave sipas Njësive Administrative

	LLOJET E TË ARDHURAVE	Njësia Qendër	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina	Pult	Shosh	Shalë	Bashkia Shkoder
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT E VETA</b>	<b>398,368</b>	<b>4,580</b>	<b>4,384</b>	<b>11,012</b>	<b>70,060</b>	<b>2,358</b>	<b>2,745</b>	<b>14,603</b>	<b>132</b>	<b>95</b>	<b>371</b>	<b>508,709</b>
<b>AJ</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE</b>	<b>146,164</b>	<b>2,101</b>	<b>1,890</b>	<b>6,899</b>	<b>33,514</b>	<b>965</b>	<b>1,208</b>	<b>5,994</b>	<b>97</b>	<b>74</b>	<b>254</b>	<b>199,162</b>
<b>I.1</b>	<b>Të ardhura nga T Th B V</b>	<b>7,156</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>7,156</b>
<b>I.1.0</b>	<b>T B V (e prapambetur)</b>	<b>218</b>	-	-	<b>26</b>	-	-	-	<b>26</b>	-	-	-	<b>270</b>
<b>I.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>80,488</b>	<b>2,088</b>	<b>1,859</b>	<b>3,177</b>	<b>25,504</b>	<b>965</b>	<b>957</b>	<b>3,064</b>	<b>97</b>	<b>74</b>	<b>216</b>	<b>118,489</b>
<b>I.2.1</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat</b>	<b>72,593</b>	<b>1,376</b>	<b>1,348</b>	<b>2,053</b>	<b>22,405</b>	<b>641</b>	<b>612</b>	<b>2,443</b>	<b>63</b>	<b>37</b>	<b>186</b>	<b>103,757</b>
<b>I.2.2</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore</b>	<b>632</b>	<b>321</b>	<b>225</b>	<b>472</b>	<b>505</b>	<b>214</b>	<b>229</b>	<b>118</b>	<b>17</b>	<b>20</b>	<b>8</b>	<b>2,759</b>
<b>I.2.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa mbi truallin</b>	<b>7,264</b>	<b>391</b>	<b>286</b>	<b>652</b>	<b>2,593</b>	<b>110</b>	<b>116</b>	<b>503</b>	<b>18</b>	<b>17</b>	<b>22</b>	<b>11,973</b>
<b>I.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel</b>	<b>1,087</b>	-	-	-	<b>5,259</b>	-	-	-	-	-	<b>16</b>	<b>6,362</b>
<b>I.4</b>	<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	<b>49,244</b>	-	<b>23</b>	<b>3,400</b>	<b>2,003</b>	-	-	<b>2,821</b>	-	-	<b>22</b>	<b>57,513</b>
<b>I.5</b>	<b>Të ardhura nga taksa e tabelës</b>	<b>7,971</b>	<b>14</b>	<b>7</b>	<b>297</b>	<b>748</b>	<b>0</b>	<b>251</b>	<b>83</b>	-	-	-	<b>9,372</b>
<b>A.II</b>	<b>TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA</b>	<b>50,587</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>50,587</b>
<b>II.1</b>	<b>Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura</b>	<b>43,786</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>43,786</b>
<b>II.2</b>	<b>Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë</b>	<b>6,769</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>6,769</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhura nga taksa e rentës minerare</b>	<b>33</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>33</b>
<b>A.III</b>	<b>TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>181,605</b>	<b>2,408</b>	<b>2,400</b>	<b>3,949</b>	<b>34,658</b>	<b>1,341</b>	<b>1,507</b>	<b>6,786</b>	<b>34</b>	<b>21</b>	<b>114</b>	<b>234,822</b>
<b>III.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave</b>	<b>115,390</b>	<b>2,115</b>	<b>2,036</b>	<b>3,147</b>	<b>5,259</b>	<b>1,218</b>	<b>1,372</b>	<b>5,910</b>	<b>33</b>	<b>17</b>	<b>97</b>	<b>136,593</b>
<b>III.1.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje</b>	<b>34,047</b>	<b>965</b>	<b>694</b>	<b>853</b>	<b>1,610</b>	<b>565</b>	<b>488</b>	<b>618</b>	<b>17</b>	<b>13</b>	<b>45</b>	<b>39,915</b>
<b>III.1.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione</b>	<b>618</b>	-	<b>6</b>	-	<b>39</b>	-	-	<b>22</b>	-	-	-	<b>684</b>
<b>III.1.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi</b>	<b>80,725</b>	<b>1,149</b>	<b>1,336</b>	<b>2,294</b>	<b>3,610</b>	<b>653</b>	<b>884</b>	<b>5,270</b>	<b>16</b>	<b>5</b>	<b>52</b>	<b>95,994</b>
<b>III.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>24,276</b>	<b>121</b>	<b>120</b>	<b>429</b>	<b>758</b>	<b>64</b>	<b>82</b>	<b>304</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>26,156</b>
<b>III.2.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje</b>	<b>12,711</b>	<b>61</b>	<b>43</b>	<b>167</b>	<b>102</b>	<b>35</b>	<b>32</b>	<b>42</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>13,192</b>
<b>III.2.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione</b>	<b>140</b>	-	-	-	-	-	-	<b>5</b>	-	-	-	<b>145</b>
<b>III.2.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi</b>	<b>11,425</b>	<b>61</b>	<b>78</b>	<b>263</b>	<b>656</b>	<b>30</b>	<b>49</b>	<b>257</b>	-	-	-	<b>12,818</b>
<b>III.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin</b>	<b>18,586</b>	-	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>635</b>	-	-	<b>58</b>	-	-	-	<b>19,288</b>
<b>III.3.1</b>	<b>Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje</b>	<b>6,431</b>	-	<b>2</b>	-	<b>4</b>	-	-	<b>0</b>	-	-	-	<b>6,437</b>
<b>III.3.2</b>	<b>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione</b>	<b>140</b>	-	-	-	-	-	-	<b>5</b>	-	-	-	<b>145</b>
<b>III.3.3</b>	<b>Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi</b>	<b>12,014</b>	-	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>631</b>	-	-	<b>53</b>	-	-	-	<b>12,706</b>
<b>III.5</b>	<b>Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë</b>	<b>11,636</b>	<b>172</b>	<b>240</b>	<b>369</b>	<b>28,006</b>	<b>59</b>	<b>53</b>	<b>513</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>16</b>	<b>41,068</b>
<b>III.5.1</b>	<b>Nga tarifa shërbime administrative, kontrolli zhvillim tërësor</b>	<b>4,597</b>	<b>2</b>	<b>8</b>	<b>160</b>	<b>12</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>30</b>	<b>0</b>	-	-	<b>4,816</b>
<b>III.5.2</b>	<b>Nga tarifa për wlosje veterinerare të bagëtive të therura</b>	<b>44</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>44</b>
<b>III.5.3</b>	<b>Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit</b>	<b>444</b>	<b>24</b>	<b>92</b>	<b>39</b>	-	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>75</b>	-	<b>1</b>	-	<b>687</b>
<b>III.5.4</b>	<b>Nga tarifa parkimi për mjete të licënsuara, dhe vendpamendime</b>	<b>2,233</b>	<b>130</b>	<b>138</b>	<b>165</b>	<b>73</b>	<b>50</b>	<b>21</b>	<b>260</b>	-	<b>3</b>	<b>16</b>	<b>3,090</b>
<b>III.5.6</b>	<b>Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave</b>	<b>4</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>4</b>
<b>III.5.7</b>	<b>Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ</b>	<b>808</b>	<b>16</b>	<b>2</b>	<b>6</b>	<b>71</b>	<b>1</b>	<b>19</b>	<b>48</b>	-	-	-	<b>971</b>
<b>III.5.8</b>	<b>Nga tarifa për zënien e hapësirave publike</b>	<b>3,503</b>	-	-	-	<b>27,850</b>	-	-	<b>101</b>	-	-	-	<b>31,454</b>
<b>III.5.10</b>	<b>Nga dokumentat për tender, ankand etj.</b>	<b>2</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>2</b>
<b>III.5.11</b>	<b>Nga tarifa të institucioneve</b>	<b>11,718</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>11,718</b>
<b>III.5.11.1</b>	<i>Biblioteka "Marin Barleti"</i>	<b>21</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>21</b>
<b>III.5.11.2</b>	<i>Muzeumet</i>	<b>1,828</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>1,828</b>
<b>III.5.11.3</b>	<i>Teatri "Mgjeni"</i>	<b>845</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>845</b>
<b>III.5.11.4</b>	<i>Qendra Kulturore e fëmijëve</i>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>III.5.11.5</b>	<i>Pallati sportit "Qazim Dervishi"</i>	<b>157</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>157</b>
<b>III.5.11.6</b>	<i>Qendra Komunitare</i>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>III.5.11.7</b>	<i>Nga kopshet</i>	<b>5,635</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>5,635</b>
<b>III.5.11.8</b>	<i>Nga çerdhet</i>	<b>3,232</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>3,232</b>
<b>A.IV</b>	<b>TË ARDHURA TË TJERA</b>	<b>19,254</b>	<b>71</b>	<b>95</b>	<b>163</b>	<b>1,888</b>	<b>52</b>	<b>30</b>	<b>1,823</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>23,381</b>
<b>IV.1</b>	<b>Të ardhura nga kundrvajtjet administrative, gjyqësore</b>	<b>14,342</b>	<b>71</b>	<b>41</b>	<b>163</b>	<b>437</b>	<b>52</b>	<b>30</b>	<b>732</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>15,873</b>
<b>IV.2</b>	<b>Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi</b>	<b>3,823</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>3,823</b>
<b>IV.3</b>	<b>Të ardhura nga sekuestrime dhe zhvendime</b>	<b>857</b>	-	<b>53</b>	-	<b>1,451</b>	-	-	<b>1,092</b>	-	-	-	<b>3,453</b>
<b>IV.7</b>	<b>Të ardhura të tjera</b>	<b>232</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>232</b>
<b>A.V</b>	<b>TË ARDHURA NGA DONACIONET</b>	<b>757</b>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	<b>757</b>

## Paraqitja grafike e peshës specifike sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave për 8/mujorin e parë të vitin 2018 mbulohet nga Njësia Administrative qendër (qytet) me 78.3% të totalit të të ardhurave.



## Realizimi i të ardhurave në % për Njësi Administrative, në lidhje me planin v.2018 mijë/lekë

Tabela e mëposhtme pasqyron realizimin e të ardhurave në çdo njësi administrative për vitin vitit 2018, të kategorizuar sipas kategorive ekonomike.

Nr	Të ardhurat nga burimet e veta vendore	Njësia Qendër	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina	Pult	Shosh	Shalë
1	Të ardhurat nga taksat vendore	69%	57%	32%	83%	96%	14%	31%	64%	63%	13%	49%
2	Të ardhura nga taksat e ndara	117%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
3	Te ardhurat nga tarifat vendore	87%	55%	44%	74%	72%	37%	45%	49%	3%	2%	10%
4	Te ardhura te tjera	194%	21%	28%	20%	266%	15%	9%	171%	0%	0%	1%
5	Te ardhura nga donacionet	247%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%
	<b>TOTALI</b>	<b>84%</b>	<b>36%</b>	<b>27%</b>	<b>60%</b>	<b>78%</b>	<b>15%</b>	<b>26%</b>	<b>48%</b>	<b>6%</b>	<b>3%</b>	<b>11%</b>



### III. Realizimi i buxhetit te 8-mujorit 2018

Realizimi i buxhetit te vitit 2018 eshte bere duke respektuar nenin 64 te ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore “, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar , ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit te njesive te qeverisjes vendore” , udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” , udhezimin plotesues të Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr.2 dt 19.01.2018 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2018” ; ligjin 109/2017 dt 30.11.2017 “Per buxhetin e vitit 2018” dhe VKB nr.85 dt 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkodër”


Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, të realizuara ne 8 M e vitit 2018 , nga te gjitha burimet e financimit, arritën në 1,630,293 mije lekë me një nivel realizimi prej 50.5 për qind.

000/leke

Emertimi	Plani Korrigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	720,429	406,632	56.4%
Shpenz.Operative	825,951	419,951	50.8%
Subvencione	3,000	-	0.0%
Transferime	919,489	611,641	66.5%
Investime	756,717	192,069	25.4%
<b>Totali</b>	<b>3,225,586</b>	<b>1,630,293</b>	<b>50.5%</b>



Peshen me te madhe te realizimit ne perqindje e zene transferimet ne masen 66.5 % ku perfshihen ndihmat ekonomike dhe pagesa e personave me aftesi ndryshe ne shumen 515 443 mije leke si transferte e kushtezuar .



*000/ lekë*





Shpenzimet per paga rreth 55.5 % jane realizuar me burim financimi Burimet e Veta , rreth 41.7% me Transferte Specifike, 0.1% me donacion dhe 2.7 % me Transferte te Kushtezuar.

Shpenzimet operative rreth 84.9 % jane realizuar me Burimet e veta, 14.8 % me Transferte Specifike, 0.4% me donacion .

Shpenzimet per transferime jane realizuar me transferte te kushtezuar me rreth 84.5% ,me Burimet e veta 13.7 % dhe 1.8 % me transferte specifike.

Shpenzimet per investime rreth 72.8 % jane realizuar me Burimet e Veta , 1.1 % me transferte specifike , 23.9% me transferte te kushtezuar dhe 2.2 % me donacione.

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve te financimit paraqitet si me poshte:



Fondi rezerve per vitin 2018 eshte planifikuar ne shumen prej 6 000 mije leke dhe nuk eshte perdorur akoma gjate 8 M te vitit 2018.



Ne zbatim te pikes 4 te VKB nr.85 dt 26.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2018 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2018-2020 të Bashkisë Shkodër” gjate 8 M te 2018 jane miratuar 18 vendime per rishperndarjen e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program; rishpërndarjen ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program; rishpërndarjen brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësjive të ndryshme shpenzuese. Konkretisht si me poshte:

Vendime		Qellimi
Nr.	Date	
74	19.03.2018	Ridetajim te fishes se Sherbimit te mirembajtjes te varrezave publike dhe varrezave te deshmoreve
118	17.05.2018	Miratimi i rishperndarjes se fondit te zerave te projekteve te investimeve brenda te njejtit program per vitin 2018
121	23.05.2018	Miratimi i rishperndarjes se fondit te zerave te projekteve te investimeve brenda te njejtit program per vitin 2018
150	22.06.2018	Miratimi i rishperndarjes se fondit te zerave te projekteve te investimeve brenda programit 4530, menaxhimi rrugeve,pakesime nga teprica te kontratave te zbatimit te lidhura ne 2018 dhe shtesa investimesh per vitin 2018
154	26.6.2018	Miratimi i risjperndarjes se fondit brenda programit 4570, Transporti Publik, nga zeri i projekteve te investimeve ne zerin e projekteve te investimeve Drejtoria e Sherbimeve Publike.
169	13.7.2018	Miratimi i rishperndarjes se fondeve te zerave te shpenzimeve korrente brenda te njejtit program per vitin 2018
182	19.7.2018	Miratim Rishperndarje fondi brenda programit 8140, Zhvillimi i Sportit
184	23.7.2018	Miratim rishperndarje fondi brenda programit 4130,Mbeshtetje dhe Zhvillim Ekonomik per vitin 2018
186	2.8.2018	Miratim rishperndarje e fondit ndermjet artikujve, brenda te njejtit program te buxhetit 2018, Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi (P9F1O2A9)
187	3.8.2018	Miratim rishperndarje fondit te zerave te projekteve dhe investimeve brenda programit 4530, Menaxhimi i rrugeve
192	8.8.2018	Miratim Rishperndarje fondi brenda programit 9120, Arsimi Parashkollor (Kopshtet)
193	9.8.2018	Miratim rishperndarje brenda programit 10140, Cerdhet
194	9.8.2018	Miratim Rishperndarje fondi brenda programit 8250, Kultura
197	16.8.2018	Miratim rishperndarje fondi brenda programit 9230 Arsimi parauniversitar (mesem-pergjithshem) DEK
201	28.8.2018	Miratim rishperndarje fondi brenda programit 4530, Menaxhimi i rrugeve
202	31.8.2018	Miratim shperndarje fondi brenda programit 8140 Zhvillimi i Sportit


### Transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat e veta vendore

Të ardhurat e veta përfshijnë transfertën e pakushtezuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhura nga burime të tjera. Këto burime të ardhurash, janë burimi kryesor i buxhetit të bashkise dhe zene 59.5 % të totalit të buxhetit të planit të korrigjuar. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë vitit 2018 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhon burimet e veta dhe siguron të ardhurat e nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve. Totali i shpenzimeve të realizuara me burim financimi transfertën e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore është 41.9 % , pagat janë realizuar në masën 51.8 % , shpenzimet operative 51.2 % , transferimet në masën 59.7% dhe investimet në masën 21.7 % .

000/leke



Në totalin e shpenzimeve të realizuara me burim financimi transfertën e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta vendore shpenzimet për paga zene rreth 28 % , shpenzimet operative zene rreth 44.2 % , shpenzimet për transferime zene 10.4 % dhe shpenzimet për investime zene rreth 17.4 % të totalit të realizuar nga ky burim.



## Transferta specifike

Ne vitin 2018 bashkia vazhdon te kryeje funksionet e transferuara me burim financimi transferten specifike.

### Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2018, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Për Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve/punonjës mbështetës, janë alokuar fonde për paga dhe sigurime shoqërore për 239 punonjës të transferuar.

Për punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, janë alokuar fondet për paga dhe sigurime shoqërore për 43 punonjës të transferuar.

Bashkia Shkoder, per te perballuar pagat dhe sigurimet shoqerore te ketij funksioni , ka parashikuar qe ne fillim te vitit, fond edhe nga te ardhurat e bashkise .

### Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën specifike te vitit 2018, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fonde bëjnë pjese fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative. Shuma e alokuar eshte 34 441 mijë lekë, numri i punonjësve 35.

### Rrugët rurale

Në transfertën specifike të vitit 2018, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Për këtë funksion për vitin 2018 I janë akorduar 18 396 mijë lekë.

### Administrimi i pyjeve

Në transfertën specifike te vitit 2018, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond perفشiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.Për këtë funksion për vitin 2018 janë alokuar 9 226 mijë lekë, numri I punonjësve është 14.

### Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën specifike të vitit 2018, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond perفشiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.Për këtë funksion për vitin 2018 i janë alokuar 26 734 mijë lekë, numri i punonjësve është 14.

### Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën specifike të vitit 2018, Bashkisë Shkodër i janë akorduar fonde për konviktet e arsimit parauniversitar. Në këtë transfertë ishin te përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime. Fondi i alokuar për këtë funksion per vitin eshte 57 315 mije lekë .

### Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën specifike të vitit 2018 te Bashkisë Shkodër i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative për qendrën “Shpresa” Shkodër. Shuma e alokuar për këtë qendër eshte 19 371 mije lekë.


Realizimi i transfertes specifike ne total paraqitet si me poshte:

Ne totalin e shpenzimeve me burim financimi transferten specifike realizmi ne total eshte 60.6 %. Jane realizuar pagat me rreth 63.4%, shpenzimet operative me rreth 54 % , transferime me rreth 59.4 % dhe investimet me 69.3%.


000/leke

Emertimi	Plani Korrigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	267,716	169,740	63.4%
Shpenz.Operative	114,824	61,963	54.0%
Transferime	18,709	11,114	59.4%
Investime	3,100	2,148	69.3%
<b>Totali</b>	<b>404,349</b>	<b>244,965</b>	<b>60.6%</b>





Ne realizimin e shpenzimeve me transferte specifike, peshen me te madhe specifike me 69 %, e zene pagat e punonjesve .



#### Transferta e kushtëzuar

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, që zene edhe 85.3 % te totalit te transfertes se kushtezuar te akorduar ne 8 M 2018 ne shumen 757 930 mije leke ku perfshihen dhe fondet e muajve shtator dhe tetor 2018, , ushqimet e nxënësve konviktore të shkollave të mesme profesionale, ushqimi për fëmijët me aftësi ndryshe të shkollës “3 dhjetori” si dhe investime .



Realizimi i shpenzimeve me burim financimi transferten e kushtezuar ne total eshte 64.6% . Shpenzimet per paga jane realizuar ne masen 67.5% , transfertat 68.1% dhe investimet ne masen 44% .

Emertimi	Plani Korrigjuar	Fakti	Realizimi ne %
Paga dhe Sigurime	16,140	10,900	67.5%
Shpenz.Operative	8,915		0.0%
Transferime	759,272	516,785	68.1%
Investime	104,111	45,857	44.0%
<b>Totali</b>	<b>888,438</b>	<b>573,542</b>	<b>64.6%</b>

000/leke







Ne transferen e kushtezuar , peshen me te madhe specifike prej 90.1 % , e zene transferimet , fondi i ardhur per pagesen e ndihmes ekonomike, paaftesise dhe invaliditeti



Bashkia vazhdon zbatimin e projektit “Po të ardhmes”, të Programit Italo-Shqiptar të Konvertimit të Borxhit (IADSA), në rikonstruksionin dhe arredimin e Qendrës së parë Rinore Publike, në Bashkinë Shkodër. Krijimi i qendres rinore synon nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive ne formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër. Nepermjet funksionimit, konsolidimit te sherbimeve si: informim, edukim dhe trajnime profesionale prane qendres rinore publike, do te arrihet krijimi i kushteve për vajzat dhe djemtë të shprehin aftësitë dhe krijimtarinë e tyre. Projekti i plote eshte ne shumene leke 54.815 mije leke, i parashikuar per vitin 2017 dhe vitin 2018. Realizimi për kete vit është në shumën 30,016 mijë lekë dhe ne total per dy vitet 36,711 mije leke.

**Detyrimet e prapambetura të bashkisë Shkodër, te trasheguara nga zbatimi i Reformes Territoriale**

Sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 "Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder" Bashkia Shkoder, jane miratuar detyrimet e trashguara nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata, me fondet perkatese te tyre. Kjo procedure eshte ndjeke, në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territoriale"

Gjatë vitit 2018 bashkia Shkodër ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresat nr.132 Prot, date 04.01.2018 për tremujorin e IV-t të vitit 2017, me nr.4954 prot, datë 04.04.2018, për tremujorin e parë të vitit 2018, dhe nr.10743 Prot, datë 05.07.2018 për tremujorin e dytë të vitit 2018.

Detyrimi i mbetur është 63,861 mijë leke, nga këto janë 29,781 mijë lekë detyrime në investime të cilat kanë parregullsi dokumentacioni ligjor dhe financiar, 838 mijë lekë detyrime për mallra dhe Shërbime ndër të cilat subjektet nuk kanë dorëzuar faturë, 31,577 mijë lekë detyrime për vendime gjyqësore të cilat janë në proces gjyqësor.

Detyrimet e FSHZH-se jane likuiduar plotesisht.

Deri ne fund te vitit 2018, Bashkia Shkoder, do te rivleresoje mundesine e likuidimit te ketyre detyrimeve, duke kontrolluar dokumentacionin ligjor dhe financiar, ne drejtim te rregullsise se procedurave dhe dokumentave financiare.

#### **Likuidimi i detyrimeve te vonuara të krijuara në fund të vitit 2017 si rezultat i pezullimit të pagesave (limitit të përdorimit të cash-it)**

Në fund të vitit 2017, u krijuan rishtazi detyrime të palikuiduara për Bashkinë Shkodër , raportuar deri me datë 28.12.2017, në shumë totale 131,987 mijë lekë, të ndara, në zërin shpenzime operative në shumën 91,473 mijë lekë dhe në zërin Investime dhe projekte në shumën 38,663 mijë lekë, të tjera në shumën 1,851, mijë lekë. Këto detyrime janë krijuar nga pezullimi i pagesave për:

- projektet e financuara nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me shkresën nr.13433 prot, datë 02.10.2017 ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë,
- projektet e Investimeve të Ujitjes dhe Kullimit dhe Rrugëve Rurale me shkresën nr.13434 prot, datë 02.10.2017.
- vendosje limit ne pagesa, me shkresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.15973 prot, datë 09.11.2017, shkresë nr 18123. prot me datë 05.12.2017 me objekt "Mbi limitin e përdorimit të cash-it për njësitë e qeverisjes vendore" për muajin Nëntor dhe Dhjetor.

Deri me datë 30.04.2018 u likujduan detyrimet e krijuara si me sipër, në zërin shpenzime operative në shumën 86,351 mijë lekë, Investime dhe projekte janë likujduar në shumën 38,663 mijë lekë, të tjera në shumën 1,851 mijë lekë .

## P1. Programi i Administratës Vendore (Planifikim, Menaxhim, Administrim)

### Hyrje

Programi i administratës vendore përcakton menaxhimin dhe mbështetjen administrative për programet e tjera të punës, veçanërisht në vazhdimësinë e zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në të gjitha nivelet e institucionit për të mundësuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe kuadrit ligjor në funksion.

### Politikat e zhvillimit

**Qeverisja jonë lokale do të bazohet në parimet e sundimit të ligjit, përgjegjësisë, llogaridhënies, besimit, transparencës, efektivitetit, efikasitetit, partneritetit dhe koherencës.**

Meqënëse qeverisja e mirë ndërlihet me aftësinë e Bashkisë për të siguruar shërbimin më të mirë për komunitetin, çdo anëtar është aktiv për të dhënë kontributin e tij. Prandaj, për ne ekziston një nevojë e vazhdueshme që Bashkia të veprojë si lehtësuese duke iu prirë qytetarëve:

- drejt të menduarit strategjik,
- duke i përfshirë ata në çështjet e pushtetit lokal,
- duke i bërë partnerë në zgjidhjen e problemeve.

Politikat e vazhdueshme, e cila do të zbatohet nga administrata e bashkisë së Shkodrës do të jenë:

I. Një strukturë menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

II. Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve.

III. Dixhitalizmi i administratës publike është dhe do të mbetet një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore

Ne jemi të angazhuar për të shtuar dhe promovuar shërbimet elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore. Është realizuar ofrimi i shërbimeve administrative elektronike ndaj qytetarëve në Bashkinë Qender dhe në Njesitë Administrative.

## F1 Administrata vendore

### F1.O1. Burime Njerëzore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori 2018
<b>Përmirësimi i qeverisjes lokale, nëpërmjet përdorimit efektiv të burimeve njerëzore.</b>	Përmirësuar qeverisja lokale duke rritur efektivitetin e përdorimit të burimeve njerëzore.	Realizuar pagat dhe sigurimet shoqërore të administratës, kompensimet për kryefamiliarët me më shumë se 3 fëmijë .
<b>Rekrutimi i Administratës Vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve.</b>	Rekrutimi për vendet vakante në zbatim të ligjit "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe VKM- ve përkatëse .	
<b>Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore (planifikuese dhe menaxhuese) nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.</b>	Është në proces . Po vazhdohet me trajnimin e detyrueshëm të punonjësve të rekrutuar dhe do vijohet më tej trajnimi i punonjësve për detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës.	
<b>Përgatitja e dokumentacionit dhe realizimi i procedurave të prokurimit publik duke patur si kriter përdorimin me efikasitet të fondeve publike.</b>	Përmirësuar përgatitja dhe realizimi i procedurave të prokurimit publik duke rritur efikasitetin e përdorimit të fondeve publike.	Njësia e Prokurimeve Publike ka realizuar 126 procedura prokurimi, nga të cilat: 9 procedura të hapura, 37 procedura kërkesë për propozim, 73 procedura blerje me vlerë të vogël, 6 procedura shërbim konsulence dhe 1 procedurë Amendament për mbulimin e nevojave të fillimit vitit. Janë në proces 25 procedura prokurimi
### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi i 8-mujorit 2018 në mijë lekë
<b>P8.F3.O1.A1.</b> Mbledhja dhe azhurnimi i informacionit për subjektet ndotëse dhe shrytëzuese të burimeve ujore të pëllgut ujëmbledhës, Bashkia Shkodër.	0	0
<b>P8.F3.O1.A2.</b> Organizimi dhe hartimi I draftit përfundimtar të databases së përdoruesve së burimeve ujore ne Bashkinë Shkodër.	0	0
<b>P8.F3.O1.A3.</b> Ndërtimi i hartës së kadastrës ujore.		

**F4. Administrimin e pyjeve dhe kullotave vendore si dhe menaxhimin e institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.**

**F4.O1. Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullor brenda territorit administrativ të bashkisë.**

Situata e synuar 2018	Realizimi i objektivave 8 mujorit 2018	Realizimi i produkteve 8-mujori - 2018
-----------------------	--	--

Realizimi i mbrojtjes se siperfaqeve pyjore/kullosore nëpërmjet një qeverisje të mirë të fondit pyjor/kullosor.	Në zbatim të detyrave funksionale për realizimin e shërbimit të Mbrojtjes se Pyjeve /kullotave parashikohen të krijohen njesitë vullnetare të shuarjes se zjarreve.	Janë ngritur njesitë vullnetare të shuarjes së zjarreve pranë NJA Guri i Zi, Posttribë, Pult, Shosh , Shalë.
Administrimi i shërbimit të pyjeve/kullotave	Plotesimi i struktures se Administrimit te sektorit te pyjeve sipas transfertës specifike .	Eshte plotesuar struktura e Sektorit te Pyjeve prane DSHBP me specialiste/teknike ne funksion te konsolidimit te shërbimit të Administrimit të pyjeve /kullotave .

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi i 8-mujorit 2018 në mijë lekë
<b>P8.F4.O1.A1.</b> Mbrojtja e siperfaqeve pyjore /kullosore/shërbimi pyjor sipas mënyrës së përcaktuar në ligj.	<b>3076</b>	<b>1893</b>
<b>P8.F4.O1.A2</b> Administrimi i shërbimit te pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Shkoder.	<b>9209</b>	<b>3513</b>

#### F4.O2. Hartimi/rishikimi i Planeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor/kullosor në bashkinë Shkodër.

Situata e synuar 2018	Realizimi i objektivave 8 mujorit 2018	Realizimi i produkteve 8-mujorit 2018
Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hartimit të Planit te menaxhimit për NJA Postribe.	Nxjerrja e problematikave te planit te menaxhimit te ish Komunes Postribe.	Jane evidentuar zonat pyjore te cilat nuk kane qene pjese e Planit te menaxhimit te ish Komunes Postribe si edhe problematikat.
Regjistrimi dhe inventarizimi i pyjeve dhe kullotave –NJ A Pult	Rishikimi i kufijve të ekonomive pyjore kullosore sidomos ato që janë në kufijtë ndarës me Zonat e Mbrojtura dhe NJA Shalë, pritet konfirmimi i azhornimeve të kryera të cilat do të shoqërohen me VKM, pas kësaj do të plotësohen për regjistrim.	Jane rishikuar kufijte e zones pyjore NjA Pult dhe NJA Shale si edhe zones se Mbrojtur. Regjistrimi i pronave Pyje/Kullota referuar shkreses nr 5548/1 dat 06.07.2018 te K/Regjistruetit Tirane , do te kryhet ne kuader te Projektit te BB per Shërbimet Mjedisore.Jane perpunuar hartat per 50 ngastra te NJA Pult.

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O2.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8 mujorit 2018 ne mije leke
<b>P8.F4.O2.A1</b> Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hatimit të Planit të menaxhimit për NJA Postribe.	0	0
<b>P8.F4.O2.A2</b> Përgatitje e materialeve per Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit te Pyjeve dhe kullotave bashkiake..	0	0

#### F4.O3. Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/kullosore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni (Projektim/Investim).

Situata e synuar 2018	Realizimi i objektivave 8 mujorit 2018	Realizimi i produkteve 8-mujorit 2018
<b>Realizimi i projektit per Rehabilitimi mjedisor/social i guroreve ne malin e Taraboshit</b>	Pergatitje e projekt idese mbas mbledhjes se informacioni ne terren dhe hartografik per realizimin e projektit.	Eshte hartuar projekt idea bazuar ne harten e ndrhyrjes dhe jemi ne fazen e pergatitjes se preventivit per projektin “ Rehabilitim mjedisor /social i guroreve ne Tarabosh”.
<b>Ndërtim prita në perrenj, Kaprre, përroi Shehu i Bardhë. ( NJA Shalë)</b>	Lidhja e kontrates se zbatimit.	Është lidhur Kontrata e siper marrjes per realizimin e objektit “ Ndertim prita malore”
<b>Hartim projekte teknike për Pyllëzim sipërfaqe pyjore në NJA Rrethina, Guri i Zi, Postribë( sipërfaqet e djegura)</b>	Pergatitja e materialeve per projekt zbatimin e projektit “ Pyllëzim sipërfaqe te djegura”	Eshte pergatitur projekt idea e projektit se bashku me hartat dhe materialet pershkrimore, po punohet me hartimin e preventivit dhe perfundimin e projektit..
<b>Pastrimi/permiresimi I parcelave pyjore ne Shale, Shosh.</b>	Lidhja e kontrates se zbatimit .	Eshte lidhur kontrata e zbatimit te punimeve per realizimin e projektit te pastrimit ne NJA Shosh-EP Shosh 2 dhe NJA Shale, EP .Lugina e Shales.
<b>Sinjalistike pyjore ne NJA Shalë, Postribë</b>	Realizimi i objektit .	Eshte realizuar objekti.
<b>Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota Shale, Postribe.</b>	Realizimi i objektit	Eshte realizuar objekti i luftimit te semundjeve.
<b>Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota -Guri i Zi, Shosh</b>	Lidhja e kontrates se zbatimit.	Eshte lidhur kontrata e zbatimit te punimeve dhe jane duke u kryer punimet per 2 lerat e ujit.

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F4.O3

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 4 mujorit 2018 ne mije leke
------------	----------------------	---------------------------------------

<b>P8.F4.O3.A1.</b> Hartim i projektit "Rikualifikimi mjedisor/social i guroreve ne malin e Taraboshit.	0	0
<b>P8.F4.O3.A2.</b> Ndërtim prita në NJA Shalë.	3060	Procedure realizimi te objektit
<b>P8.F4.O3.A3</b> Hartim projekte teknike për Pyllëzim në sipërfaqet pyjore në Rrethina , Guri i ZI dhe Posttribe. ( sipërfaqet e djegura)	0	Ne process te hartimit te projektit.
<b>P8.F4.O3.A4.</b> Pastrimi/përmiresimi I parcelave pyjore NJA Shale, Shosh	1020	Procedure realizimi te objektit
<b>P8.F4.O3.A5.</b> Sinjalistike pyjore ne zonat pyjore te NJA.	204	174
<b>P8.F4.O3.A6.</b> Luftimi i semundjeve dhe demtuesve ne pyje/kullota ne NJA.	510	414
<b>P8.F4.O3.A7.</b> Zbatimi i projektit per ndertimin e leres se ujit kullota –në NJA.	1020	Procedure realizimi te objektit

**Realizimi i shpenzimeve për programin P8. Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave 000/lekë**

Programi P8	Paga Sigurime	+ Shpenzime Operative	Transferime	Investime	Totali
<b>Plani 2018</b>	12,985	3,354	51	6445	<b>22,834</b>
<b>Realizimi mujorit të 2018</b>	8- 3,593	1,147	43	1,140	<b>5,923</b>

## P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi

### 7. Hyrje

Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në rritjen e zhvillimit ekonomik dhe social të komunitetit tonë. Shkolla duhet t'i mundësojë çdo fëmije që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucioneve arsimore për 11 njesitë administrative. (93 objekte shkollore, 60 kopshte, 2 konvikte dhe 1 shkolle speciale), që kërkojnë një vëmendje të veçantë. Synimi ynë është menaxhimi me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për një zhvillim e shfrytëzim cilësor të infrastrukturës së institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër. Në kuadër të reformës së re administrative të qeverisjes vendore janë pjesë e këtij programi edhe delegimi i funksioneve të reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (Parashkollor dhe të Qendres Kulturore), punonjësit e shërbimeve mbështetëse të Arsimit të Mesëm.

### 8. Politikat e zhvillimit

Sigurimi i shërbimeve mbështetëse, cilësore në të gjithë territorin, për institucionet e edukimit parauniversitar dhe atij parashkollor gjatë procesit të realizimit të programit mësimor vjetor.

Përmirësimi i sistemeve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe ndërlidhja e politikës arsimore me politikën social-ekonomike.

Mbështetja dhe promovimi i cilësisë së mësimdhënies dhe i rezultateve të larta në shkollë. Promovimi dhe nxitja e hapjes së strukturave të edukimit jashtë orarit mësimor, për të plotësuar një nga të drejtat bazë të fëmijëve, siç është argëtimi, loja, sporti etj

## Funksionet:

### F1.F2. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

#### O1 Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor edukativ në kushte të pershtatshme në gjithë territorin administrativ të Bashkisë Shkoder;

Situata e synuar 2018	Realizimi i objektivave 8-mujori I-re 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori 2018
<b>Te kryehen të gjitha pagesat për 222 administrate dhe personel ndihmës në shkollat e Bashkisë së Shkodrës;zyres se arsimit dhe te konvikteve</b>	Janë realizuar të gjitha pagesat për 222 personel ndihmës në shkollat e Bashkisë së Shkodrës; zyres se arsimit dhe te konvikteve	Kane marre pagesat 222 personel ndihmës në shkollat e Bashkisë së Shkodrës zyres se arsimit dhe te konvikteve
<b>Sigurimi i funksionimit normal te objekteve arsimore(shkolla/konvikte), nepermjet shërbimeve mbeshtetese</b>	Permiresimi i kushteve me ane te sigurimit te shërbimeve baze me qellim funksionimin sa me normal te objekteve shkollore(shkolla, konvikte)	Realizimin e pagesave te shërbimeve,energji elketrike, uje, te objekteve shkollore(shkolla, konvikte) dhe internet per QKF
<b>Sigurimi i materialeve baze per funksionimin e shërbimeve mbeshtetese</b>	Permiresimi i kushteve me ane te sigurimit te materialeve per shërbimet mbeshtetese, me qellim funksionimin sa me normal te objekteve shkollore(shkolla, konvikte)	Jane realizuar blerjet e materialeve hidraulike, dhe materialve te ndryshme. Ne proces te realizimit te blerjeve te materialeve (batanije, carcafe, ene kuzhine etj)materialeve te kancelarise,
<b>Sigurimi i ushqimit per nexenesit e konvikteve dhe shkolles special.</b>	Realizimin e shërbimit te menses duke ofruar vaktet e ushqimit per nexenesit qeperfitojne bursakonvikteve dhe shkolles speciale	Sigurimi i vakteve ushqimore per 120 nxenes te konvikteve(perfitues burse) dhe 90 nxenes te shkolles Speciale si dhe stafit te shkolles speciale.
<b>Krijimi i kushteve optimale per ngrohjen ne shkolla dhe konvikte</b>	Permiresimi i shërbimit te ngrohjes me qellim funksionimin sa me normal te procesit mesimor	Realizimi i shërbimit te ngrohjes nepermjet sigurimit te druve te zjarrit, gazit te lengshem dhe naftes ne kaldaja.
<b>Sigurimi i shërbimit te transportit te femijeve shkolla spciale 3 Dhjetori</b>	Permiresimi i shërbimit te transportit te 90 femijeve qe frekuentojne shkollen Speciale.	Realizimi i shërbimit nepermjet mirembajtjes se automjetit te transportit dhe sigurimit te karburantit per kete automjet.
<b>Sigurimi i objekteve shkollore per raste te ngjarjeve te jashtezakoneshme si zjarr dhe termete :konvikte, magazina, objekte shkollore Kopshte.</b>	Sigurimin e standarteve per sigurimin ndaj zjarrit dhe termetit për: konvikte, magazina, Objekte Shkollore kopshte	Ne proces per te realizuar shërbimin e sigurimit ndaj zjarrit dhe termetit konvikte, magazina, objekte shkollore kopshte

<b>Permiresimi I kushteve te higjenes ne konvikte , shkolles speciale dhe magazines</b>	Sigurimin e standarteve per sigurimin e higjenes për: konviktet, magazina, kopshte	Ne proces per te realizuar sherbimin e dizinfektimit ne: konvikte, magazina, kopshte.
---	--	---

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.F2.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori I-rë 2018 në mijë lekë
<b>P9.F1.O1.A1</b> Pagat dhe sigurime shoqerore per punonjesit e arsimit	<b>118,908</b>	<b>76 319</b>
<b>P9.F1.O2.A21</b> Mbeshtetje per mirembajtjen e infrastructures sherbimeve mbeshtetse per nxenesit dhe stafin mbeshtetes ne shkolla (9120+9230; Inv estimate 9120)	<b>72 151</b>	<b>20273</b> Ne proces realizimi.
Blerje materialesh (batanije, çarçafë, peshqirë dhe mbulesa tryezash) në shërbim të konvikteve.	<b>100</b>	<b>Parashikuar ne muajt ne vazhdim</b>
Blerje ene kuzhine per konviktete dhe shkollen Speciale	<b>80</b>	<b>Parashikuar ne muajt ne vazhdim</b>
Blerje ushqime per konviktet e shkollave te mesme dhe shkollen 3 Dhjetori.	<b>10144</b>	<b>1 289</b> ne proces realizimi.
Blerje materiale kancelarie per sistemin arsimor parauniversitar	<b>1100</b>	<b>Ne proces Depozitim Kontarate</b>
Blerje materiale te ndryshme per sherbimet mbeshtetese per sistemin arsimor parauniversitar	<b>710</b>	<b>515</b>
Blerje pjese kembimi per mirembajtjen e sistemeve hidraulike te sistemit arsimor parauniversitar	<b>560</b>	<b>319</b>
Blerje materiale pastrimi ambientesh	<b>1,880</b>	<b>Ne proces Depozitim Kontarate</b>
Blerje dru zjarri per ngrohje per sistemin e arsimit parauniversitar.	<b>13,400</b>	<b>Ne proces Prokurimi</b>
Blerje gaz te lengshem per ngrohje per sistemin arsimor parashkollor dhe sistemin arsimor parauniversitar.	<b>4500</b>	<b>Ne proces Depozitim Kontarate</b>
Blerje lende djegese karburante per ngrohje dhe per mjete transporti(nafte +benzine).	<b>2,090</b>	<b>1418</b>
Riparim paisje orendi	<b>100</b>	<b>80</b>
Mirembajtje e mjeteve te transportit per sherbimet mbeshtetese te sistemit arsimor parauniversitar dhe sistemit arsimor parashkollor.	<b>200</b>	<b>67</b>
Furnizim me energji elektrike, uje, Sherbime postare , Sherbim interneti per te gjitha shkollat ne territorin e Bashkise.	<b>18,685</b>	<b>15451</b>
Blerje xham per mirembajtjen e dritareve te godinave te sistemit arsimor	<b>290</b>	<b>289</b>
Mirembajtje e zakonshme e objekteve arsimore	<b>8150</b>	<b>Ne proces zbatimi</b>





Sigurimi I objekteve per raste te ngjatrjve te jashtezakonshme per zjarr dhe termete	720	Parashikuar ne muajt ne vazhdim
Dizinfektimi I mjediseve te objekteve te sherbimeve mbeshtetese	100	Ne proces realizimi.

**F1.O2 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor ne sistemin parauniversitar dhe parashkollor.**

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori 2018	Realizimi i produkteve 8- mujori 2018
<b>Sigurimi i materialeve per arritjen e standarteve ne objektet shkollore.</b>	Permiresimi i kushteve ne objektet shkollore dhe konvikte, me qellim sigurimin e kushteve optimale te mesimdheies	Eshte realizuar blerja e materialeve bojra te ndryeshme, materialeve elektrike, Ne proces te realizimit te blerjeve paisjeve dhe orendive
<b>Mirembajtja e ndertesave, objekte shkollore</b>	Permiresimi i kushteve dhe objekteve Janë kryer punime lysterje dhe riparime në 18 objektet e arsimit sipas nevojës prioritare.	Realizimi i ketij sherbimi eshte ne proces , ku jane riparuar 18 shkolla.
<b>Rikonstruksione te ndertesave te shkollave</b>	Permiresimi i kushteve dhe standarteve te shkollave duke rikonstruktuar 7 objekte shkollore sipas nevojës prioritare.	Realizimi i ketij sherbimi eshte ne proces projektimi ku jane rikonstruktuar 4 shkolla sipas nevojës prioritare.

**Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2**

Aktiviteti	Buxheti në mijë lek	Realizimi 8-mujori 2018 në mijë lekë
<b>P9.F1.O2.A9</b> Ndertim I dhomave te zhveshjes dhe tribunes prane fushes sportive shkiolla 28 nentori	2,035	Ne proces zbatimi
<b>P9.F1.O2.A10</b> Vendorsja e radiatoreve dhe montimi/ instalim I kaldajes se shkolles Shejnaze Juka	6369	199 projektim, dhe ne proces prokurimi zbatimi
<b>P9.F1.O2.A11.</b> Vendorsja e radiatoreve dhe montimi/ instalim I kaldajes se shkolles 28 Nentori	4,770	124 projektim, dhe ne proces prokurimi zbatimi
<b>P9.F1.O2.A12.</b> Rikonstriksion I catise se Shkolles Veli tela Muriqan	2,600	113 projektim, dhe ne proces prokurimi zbatimi
<b>P9.F1.O2.A13.</b> Rikonstriksion I terraces se Shkolles Haxhi Hajdari te Fshatit Golem	2,200	95 projektim, dhe ne proces prokurimi zbatimi

## F2.Administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte.

**F2.O1.Ofrimi i shërbimeve cilësore për zhvillimin e procesit mesimor edukativ ne kushte të pershtatshme ne gjithë territorin administrativ te Bashkise se Shkodres.**

<b>Situata e synuar 2018 Objektivat</b>	<b>Realizimi i objektivave 8-mujori I-rë 2018</b>	<b>Realizimi i produkteve 8- mujori 2018</b>
Kryerje e rregullt e pagesave për paga, sigurime shoqërore dhe shëndëtsore të punonjesve, në mbështetje të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve me profesionalizëm, korrektësi dhe transparence ne menyre qe cdo punonjes sipas pozicionit te punes të shërbejë, të jape rezultate pozitive duke zbatuar ligjin,vendimet e bashkise dhe urdherat e titullarit te institucionit.	Mbështetje e funksionimit të 57 kopshteve në Bashkinë Shkodër për të gjithë personelin, edukator dhe atë mbështetës.	Jane realizuar pagesat per paga dhe sigurime shoqerore per 172 punonjes te personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor.

### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1:

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8 mujor
<b>P9.F2.O1 .A1.</b> Mbështetja personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor	<b>122 994</b>	<b>81 082</b>
<b>P9.F2.O1 .A4</b> Blerje pajisje orendi (shporet, lavatriçe, frigorifer, aristona, pompaujit ,fshesa me korrent,shporet per ngrohjeetj.	500	395

### F2 O2: Krijimi i ambienteve dhe mjediseve te sistemit arsimor, te sigurte konform standarteve ligjore.

<b>Situata e synuar 2018 Objektivat</b>	<b>Realizimi i objektivave 8-mujori 2018</b>	<b>Realizimi i produkteve 8- mujori 2018</b>
---	--	--

<p>Përmirësimin e kushteve sa me te favorshme per qendrimin dhe edukimin e femijeve ne kopshte:</p> <p>Furnizime me ushqime, për 350 fëmijë</p> <p>Mirembajtjen e zakonshme të ndertesave për kopshtet.</p> <p>Mirembajtjen e paisjeve teknike dhe funksionale në shërbim për kopshtet.</p> <p>Sigurimin e ndertesave të kopshteve.</p> <p>Rikonstruksion i pjesshem i kopshtit "Ismet Sali Bruçaj.</p>	<p>Mbështetja per mirembajtjen e infrastruktures se sherbimet mbeshtetese per femijet dhe stafin edukues ne kopshte.</p>	<p>Eshte realizuar pagesa e energjise elektrike, mirembajtja e kopshtit Bep Tusha, si dhe blerje pajisje dhe orendi per kopshtet. Jane blere batanije,çarçafe,peshqire,karriga,tavolina, materiale pastrimi, eshte kryer dizinfektimi per te gjitha kopshtet e planifikuara. Jane kryer blerjet per shporeta,lavatrice,frigorifer.aris tona,pompaujit ,fshesa me korrent,shporet per ngrohjeetj. Eshte perfunduar pjeserisht rikonstruksioni I kopshtit Ismet Sali Brucaj.</p>
---	--	--

### 8.1.1. Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2:

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8 mujor
<b>P9.F2.O2.A1</b> Mbështetja per mirembajtjen e infrastruktures, sherbimet mbeshtetese per femijet dhe stafin edukues ne kopshtepersonelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor.	<b>22 769</b>	<b>7670</b>
Furnizime me ushqime	12 474	1 153
Materjale zyre (kancelari)	300	144
Materjale per pastrim,dizinfektim etj	645	625
Materjale te tjera (batanije,çarçafe,peshqire,karriga,tavolina etj.)	900	888
Shpenzime per karburant	200	200
Shpenzime te tjera transporti(siguracion,kolaudim e te tjera shpenzime transporti)	70	16
Energji elektrike	900	419
Furnizim me ujë	1000	384
Lende djegese(dru zjarri)	1500	ne proces zbatimi
Lende djegese (gaz)	481	476
Lendedjegese(nafte)	400	400
Sherbime per(dizinfektim).	50	50
Sherbime per mirembajtjeteobjektevendertimore dhelyrje me bojetekopshteve.	3769	2 915
Shpenzime per sigurimin e ndertesave	80	Parashikuar ne muajt ne vazhdim
<b>P9.F2.O2.A2</b> Rikonstruksion i pjesshem i kopshtit "Ismet Sali Bruçaj"	<b>2 931</b>	<b>1 413</b>
<b>P9.F2.O2 .A3</b> Rikonstruksion i godines kopshtit "Guerile"	<b>2 886</b>	Parashikuar ne muajt ne vazhdim
<b>P9.F2.O2.A4</b> Blerje mjet transporti (furgon)	<b>1.200</b>	Parashikuar



### F3.O1.Nxitja dhe promovimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese per femije.

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori 2018	Realizimi i produkteve 8- mujori 2018
<b>Organizimi i kurseve te ndryshme ne fushen artistike, sportive dhe shkencore per rreth 500 femije.</b>	Janë ne vazhdim kurse te ndryshme ne fushen artistike, sportive dhe shkencore per rreth 500 femije.	Janë ne vazhdim kurse te ndryshme ne fushen artistike, sportive dhe shkencore per rreth 500 femije.
<b>Zhvillimi I aktiviteteve per perzgjedhjen e talenteve te rinj pergjate gjithe vitit titulluar "Bilbilat e Vegjel".</b>	Janë zhvilluar aktivitete per perzgjedhjen e talenteve te rinj pergjate gjithe vitit titulluar "Bilbilat e Vegjel".	Janë zhvilluar aktivitete per perzgjedhjen e talenteve te rinj pergjate gjithe vitit titulluar "Bilbilat e Vegjel".
<b>Realizimi I Festivalit Mbarekombetare per Femije .</b>	Te realizohet festivali I 56 mbarekombetar per femije.	Ne muajin qershor u realizua festivali I 56 mbarekombetar per femije me pjesmarrjen e femijve nga I gjithe rajoni I Ballkanit.
<b>Zhvillimi I kampionatit per femije ne disiplinat sportive basketboll, volejboll, shah, minifutboll, vrapime ndermjet shkollave 9 vjecar.</b>	Është zhvilluar kampionati per femije ne disiplinat sportive basketboll, volejboll, shah, minifutboll, vrapime ndermjet shkollave 9 vjecar.	Është zhvilluar kampionati per femije ne disiplinat sportive basketboll, volejboll, shah, minifutboll, vrapime ndermjet shkollave 9 vjecar.
<b>Zhvillimi i festes tradicionale per vitin e ri per femijet duke promovuar nxenesit me rezultate me te larta.</b>		

### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F3.O1

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori I- rë 2018 në mijë lekë
<b>P9.F3.O1 .A1 Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë</b>	<b>410</b>	<b>407</b>
<b>P9.F3.O1 .A2 Festivali i 56-t mbarëkombëtar për femije</b>	<b>4500</b>	<b>4229</b>
<b>P9.F3.O1.A3 "Veprimtari masive" (sportive, artistike e shkencore) te Qendres Kulturore te Femijeve.</b>	<b>280</b>	<b>130</b>
<b>P9.F3.O1.A4 "Veprimtari me rrethet artistike, sportive e shkencore per vitin 2018"</b>	<b>1372</b>	<b>514</b>
<b>P9.F3.O1A5 Mbrëmja Tradicionale e Vitit të Ri per nxënesit e shkollave 9 vjeçare.</b>	<b>445</b>	<b>Parashikuar ne dhjetor 2018.</b>

### Realizimi i shpenzimeve 8 M për programin P9. Arsimi parauniversitar dhe edukimi:

Programi P9	Paga + Sigurime	Shpenzime Operative	Transferta	Investime	Totali
<b>Plani 2018</b>	260,658	121,227	4,122	52,681	<b>438,688</b>
<b>Realizimi 8-M 2018</b>	157,051	57,401	4,088	14,081	<b>232 621</b>



## P10. Strehimi dhe Shërbimet sociale

### Hyrje

Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë. Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe “klima” humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet sociale më në rrezik.

Gjatë vitit 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet, Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Këto qendra u ngritën në pesë lagje të qytetit dhe në njësinë administrative Dajç dhe Guri i zi.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

Shërbimet me bazë komunitare të krijuara gjatë vitit 2016 janë të parat struktura operative në territorin e Bashkisë së Shkodrës. 7 qendra komunitare “Për Familjen” u krijuan dhe u vunë në funksion, nga një në çdo lagje të Shkodrës dhe 2 në njësinë administrative të Gurit të Zi dhe të Dajçit. Në këto qendra ofrohet informim, këshillim, orientim, mbrojtje e fëmijëve, shërbime për fëmijët dhe familjen, fuqizimi ekonomik, programe prindërimi, fuqizim komunitetit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, etj.

Në vitin 2017, në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, është arritur sigurimi i financimit për krijimin e Qendrës së parë Rinore Publike në territorin e bashkisë së Shkodrës. Kjo qendër i dedikohet përfshirjes edukative, artistike, sociale dhe kulturore të të rinjve, duke krijuar hapësirat e nevojshme dhe aksesin në sipërmarrje, kulturë, art, teknologji informacioni, etj.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 është projektuar dhe ka filluar zbatimin për ndërtimin e qendrës komunitare multifunksionale, e cila do të ofrojë shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian, por sigurisht do të jetë një qendër e gatshme dhe në shërbim të komunitetit të zonës.

Ndër shërbimet e rëndësishme, që vlen të theksohet, për vitin 2017, është koordinimi i ndërhyrjeve dhe burimeve në territor ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, për regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve rom në sistemin arsimor. Për herë të parë gjatë këtij viti, rreth 60 fëmijë rom janë regjistruar dhe kanë frekuentuar shkollën. Për secilin fëmijë dhe familje tyre janë siguruar mbështetje shumë planëshe, me synim fuqizimin dhe integrimin e tyre. Ndër shërbimet e ofruara janë; regjistrim në gjendjen civile, orientim për punësim dhe kurse profesionale, pajisje me karta shëndeti, sigurimi i materialeve didaktike të nevojshme për procesin mësimor, ndihma veshmbathje, ushqimore dhe mjekësore.

Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

### Politikat e zhvillimit

Programi i shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik bazohet në pesë politika themelore :

Mbulimi sa më të plotë të territorit me Shërbime Sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Gjithëpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskriminimi për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.:

Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me strategjitë dhe politikat kombëtare, me instiucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare:

Partneriteti i ngushtë ligjor me shoqërinë civile, organizata jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti.

Me qëllim fuqizimin e Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Shkodrës synojmë që shërbimi i Strehimit të bëhet pjesë e Shërbimit Social, duke sjellë harmonizimin dhe bashkërendimin më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë.

Përmirësimi i shëndetit, cilësisë së jetës së komunitetit përmes aktiviteteve të edukimit e promovimit shëndetësor, parandalimit të sëmundjeve dhe shërbimeve të tjera shëndetësore në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shërbimit shëndetësor

Në kuadër të ligjit nr.139/2015 “Për qeverisjen Vendore” Bashkia Shkodër ka përgjegjësinë të punojë për kryerjen e funksioneve si më poshtë. Për periudhën 2016-2019, kemi objektiva të qartë për punën tonë në përmbushjeve të detyrave funksionale. Këto objektiva janë dakordësuar me organizatat e shoqërisë Civile, Institucionet në varësi të Bashkisë Shkodër, ekspertët dhe specialistët e organizatave partnere ndërkombëtare dhe vendore me të cilat punojnë, ekspertë të Institucioneve në nivel rajonal gjatë diskutimeve për hartimin e Planit social të zonës së Shkodër.

#### Funksionet:

#### **F1.Ndërtimi dhe administrimi i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.**

#### **F1.O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë;**

#### **Situata e synuar 2018 Objektivat**

Realizimi i objektivave  
8-mujori i 2018

Realizimi i produkteve 8 –  
mujori i 2018

Projektimi dhe planifikimi i ndërhyrjeve të tjera infrastrukturore me synim përmirësimin e kushteve të banimit dhe të jetesës për 120 familje të komunitetit Rom&Egjiptian

Është në proces vlerësimi i infrastrukturës dhe hapësirave për krijimin e administrimit e ujërave të zeza, WC, etj. dhe po punohet për projektimin e tyre.

Në proces zbatimi

Shërbime integruese dhe zhvilluese për rreth 30 jetimë dhe gratë kryefamiljare të akomoduar në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”. Ky komision

26 apartamente sociale të gatshme për jetimët dhe gratë kryefamiljare.



Shkodrës. 26 apartamente sociale funksionale dhe në administrim për jetimët dhe gratë kryefamiljare pa asnjë përkrahje.

do të administrojë procesin e përzgjedhjes dhe të administrimit të apartamenteve sociale për jetimët dhe gratë kryefamiljare. Është krijuar komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Për administrimin e programeve të strehimit social pritet miratimi nga Këshilli Bashkiak.

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.01

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori i 2018 në mijë lekë
P10.F1.O1.A1 Projektim dhe ndërhyrje në infrastrukturë me synim përmirësimin e jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian.	-	Në proces zbatimi
P10.F1.O1.A2. Shërbime integruese & zhvilluese dhe administrimi i apartamenteve sociale, të krijuar për personat e dalë nga institucionet e përkujdesit rezidencial dhe gratë kryefamiljare me probleme social-ekonomike, pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" nr 6.	1,655	216

#### F1.02. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm.

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori i 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori i 2018
Vlerësim në vazhdimësi dhe aplikim për pjesmarrje në programet lehtësuese qeveritare si: bonus qeraje, banesa sociale me kosto të ulët, banesa sociale me qera, banesa me kosto të ulët, apo programin e subvencionimit të interesave të kredive nga shteti. Për familjet në nevojë dhe administrimin e këtij shërbimi.	Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”. Ky komision do të administrojë procesin e përzgjedhjes dhe të administrimit të apartamenteve sociale për jetimët dhe gratë kryefamiljare. Është krijuar komisioni i strehimit sipas Urdhërit nr. 585, datë 18.08.2017 dhe pranë Këshillit Bashkiak të Shkodrës është prezantuar sistemi i pikëzimit për përfitimin në programet e strehimit social. Për	Në proces zbatimi

	administrimin e programeve të strehimit social pritet miratimi nga Këshilli Bashkiak.	
Aplikimi pranë qeverisë dhe donatorëve potencial për ndërhyrje në infrastrukturë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetin rom dhe egjiptian.	Është realizuar vlerësimi mbi infrastrukturën e banimit dhe gjithashtu kostimi i ndërhyrjeve me synim përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin rom dhe egjiptian.	Studimi vlerësues i kushteve të banimit të komunitetit rom e egjiptian, dhe kostifikimi i nevojave për ndërhyrje, në Bashkinë e Shkodrës është i gatshëm.

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F1.O2

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori i 2018 në mijë lekë
<b>P.10.F1.O2.A1 Strehim social sipas programeve qeveritare të banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje.</b>	600	Parashikuar në muajt në vazhdim
<b>P.10.F1.O2.A2 Përgatitja e studimit të fizibilitetit mbi përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetin Rom&amp;Egjiptian në Bashkinë e Shkodrës</b>	-	Studimi është përfunduar

#### F2. Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

##### F2.O1.Mbulimi sa më i plotë i territorit të Bashkisë me shërbime sociale duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit.

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori i 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori i 2018
Ka një PLV që zbatohet në Bashkinë Shkodër. Shtrirje e shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge. Fuqizim i familjeve të këtyre fëmijëve.	Shtrirja e shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe familjeve në situatë rruge. Janë dizenuar dhe përgatitur materialet promovionale për ndërgjegjësim për fëmijët në situatë rruge.	Skudra të terrenit, të përbëra nga punonjës të qëndrave komunitare “Për Familjen” dhe policë bashkiakë, funksionale në zonat kryesore ku janë identifikuar fëmijë në situatë rruge; në zonën urbane të Bashkisë së Shkodrës dhe në pikën doganore Muriqan. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge dhe mbështetur është 100 dhe numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura është 40. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për fëmijët në situatë rruge, në bashkëpunim me DAR, Drejtorinë Vendore të Policisë dhe organizatat partnere është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues me slogan “Mos dhuro para, dhuro kujdes”.



## Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O1.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori i 2018 në mijë lekë
P10.F2.O1.A1 Zbatimi i Planit lokal të Veprimit për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.	72.65	72.65

## F2.O2 Bashkërendimi dhe harmonizimi i aktiviteteve lokale me Strategjitë dhe politikat kombëtare, me institucionet në varësi të pushtetit qendror, bashkitë fqinje dhe shtetet kufitare

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori i 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori i 2018
Lehtësimi i situatës ekonomike-sociale për familjet në nevoje; Familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, kryefamiljarë gra /burra ); persona trajtohen me pagese paaftësie; Invalidë të Punës që trajtohen me shtesë Kempj;	Identifikimi, vlerësimi dhe mbështetja financiare e familjeve në vështirësi social-ekonomike me qëllim lehtësimin e situatës së tyre sociale.	Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë; sipas vendimit të Drejtorisë Rajonale Shkodër: Në muajin Janar 2018, Nr. 01.2018 datë 10/02/2018, përfituan ndihmë ekonomike 1623 familje për gjithë Bashkinë Shkodër, nga ku 146 janë familje të qytetit. Në muajin Shkurt 2018, Nr. 02.2018 datë 01/03/2018, përfituan 1401 familje në Bashkinë Shkodër, nga ku 143 janë familje të qytetit. Në muajin Mars 2018, Nr. 03.2018 datë 30/03/2018, përfituan ndihmë ekonomike 1639 familje nga ku 193 janë familje të qytetit. Në muajin prill 2018, Nr. 04.2018 datë 07/05/2018, përfituan ndihmë ekonomike 1603 familje nga ku 169 janë familje të qytetit. Në muajin Maj 2018, Nr. 05.2018 datë 06/06/2018, përfituan 1585 familje në Bashkinë Shkodër, nga ku 183 janë familje të qytetit. Në muajin Qershor 2018, Nr. 06.2018 datë 05/07/2018, përfituan 1552 familje në Bashkinë Shkodër, nga ku 184 janë familje të qytetit. Në muajin Korrik 2018, Nr. 07.2018 datë 03/08/2018, përfituan 1576 familje në Bashkinë Shkodër, nga ku 181



janë familje të qytetit.  
Në muajin Gusht 2018, Nr. 08  
.2018 datë 05/09/2018,  
përfituan 1593 familje në  
Bashkinë Shkodër, nga ku 194  
janë familje të qytetit.

Nr. I personave të trajtuar me  
pagesë paaftësie ka qenë në  
muajin janar 4114, në shkurt,  
4179, në mars 4181, në prill  
4135, në maj 4148, në qershor  
4151, në korrik 4149, në gusht  
4149 .

Nr. I invalidëve të punës  
trajtuar me shtesë kempit ka  
qenë në muajin janar 3383, në  
shkurt, 3371, në mars 3390, në  
prill 3381, në maj 3366, në  
qershor 3386, në korrik 3328, në  
gusht 3328.

Funksionimi e konsolidimi i  
sistemit të referimit të rasteve  
për viktimat e dhunës në  
familje. Shtrirja e shërbimeve në  
territorin e Bashkisë.

Për riorganizimin dhe  
funksionimin e sistemit të  
referimit për viktimat e dhunës  
në familje është hartuar  
marrëveshja e bashkëpunimit,  
dhe janë planifikuar aktivitete  
në zbatim të kësaj  
marrëveshje.

Marrëveshja e bashkëpunimit  
për mekanizmin e referimit të  
rasteve të dhunës në familje,  
ndërmjet institucioneve publike  
dhe organizatave të shoqërisë  
civile e firmosur dhe në proces  
zbatimi. Gjatë këtij 8-  
mujori janë referuar 38 raste dhe numri  
i përfituesve nga funksionimi i  
mekanizmit është 57. Gjithashtu  
janë realizuar 3 takime të  
tryezës teknike për rastet e  
dhunës në familje.

Planifikimi dhe organizimi i  
aktiviteteve sensibilizuese të  
shtrira përgjatë javës së cilësuar  
"Java e Familjes"

Në kuadër të ditës  
ndërkombëtare të familjes,  
janë planifikuar dhe organizuar  
aktivitete përgjatë të gjithë  
javës të quajtur "Java e  
Familjes".

Gjatë javës së familjes, janë  
organizuar 7 aktivitete  
sensibilizuese me qëllim  
promovimin e vlerave të familjes  
dhe shërbimeve që ofrohen në  
fuqizim të familjes biologjike,  
promovimit të shërbimeve  
alternative me qëllim  
deinstitucionalizimin dhe  
parandalimin e  
institucionalizimit. Aktivitetet  
janë zhvilluar në qendrat  
komunitare "Për Familjen" nr 3,  
4, 5 e në Dajç dhe gjithashtu në  
shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç. Nr.  
i pjesëmarrësve në këto



		aktivitete ka qenë 350.
Studentet zhvillojnë praktikën profesionale në Bashkinë e Shkodrës në përputhje me nevojat e territorit, në shërbim të komunitetit.	Studentë të vitit të tretë në sistemin bachelor, të kursit psikologji dhe punë sociale, po zhvillojnë praktikën profesionale në Bashkinë e Shkodrës dhe institucionet në varësi të saj.	12 studentë; 11 të nivelit bachelor dhe 1 i nivelit master Po zhvillojnë praktikën profesionale pranë shërbimit social dhe kanë kontribuar në aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare.
Trajtimi, sterilizim dhe vaksinimi e matrikulimi në vazhdimësi për qentë e rrugës; Projektimi dhe ndërtimi i strehëzës për grumbullimin e qenve të rrugës;	Në proces zbatimi	
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit Gjinor. Buxhetim gjinor dhe me pjesëmarrje për buxhetin e bashkisë. Përditësim i të dhënave statistikore me bazë gjinore për Bashkinë e Shkodrës me një vëmendje të veçantë ndaj çështjeve gjinore dhe krijimin e mundësive për barazi gjinore në punësim.	Fillimi i punës për hartimin dhe përgatitjen e planit të veprimit gjinor si aktiviteti i parë në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017. Dizenjimi dhe përgatitja e materialeve promocionale.	Është realizuar draft-i përfundimtar i dokumentit të planit të veprimit gjinor. Shpërndarja e materialeve promocionale dhe ndërgjegjësuere në kuadër të aktiviteteve të organizuara për barazinë gjinore.

#### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O2.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori i 2018 në mijë lekë
<b>P10.F2.O2.A1. Ndihma ekonomike dhe PAK.</b>	<b>757,930</b>	<b>515,443</b>
<b>P10.F2.O2.A2. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.</b>	<b>300</b>	<b>Në proces përgatitje terma reference</b>
<b>P10.F2.O2.A3. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj</b>	<b>50</b>	<b>34</b>
<b>P10.F2.O2.A4. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë</b>	<b>-</b>	<b>Në proces zbatimi</b>
<b>P10.F2.O2.A5. Projektimi, ndërtimi i strehëzës dhe trajtimi i qenve të rrugës.</b>	<b>1,500</b>	<b>Në proces zbatimi</b>
<b>P10.F2.O2.A6. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.</b>	<b>142.65</b>	<b>142.65</b>

**F2.O3.Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.**

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori i 2018	Realizimi i produkteve 8 – mujori i 2018
-------------------------------------	--	---

<p>Konsolidimi i tryezës konsultative dhe organizimi i takimeve periodike, së pakut 4 tryezave në vit.</p> <p>Planifikimi e organizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për respektimin e të drejtave të fëmijës me pjesëmarrjen aktive të fëmijeve.</p>	<p>Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile.</p> <p>Parashikuar në muajt në vazhdim.</p>	<p>Janë realizuar 12 takime konsultative me organizatat partnere. Pjesëmarrëse kanë qenë 18 organizata.</p>
<p>Organizim i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere në kuader të ditës ndërkombëtare për të moshuarit.</p>	<p>Parashikuar në muajt në vazhdim.</p>	
<p>Organizim i aktivitetit sensibilizues në kuadër të ditës "3 dhjetori" , dita ndërkombëtare për personat me aftësi ndryshe me pjesëmarrje të gjërë institucioneve, organizatave dhe individëve;</p>	<p>Parashikuar në muajt në vazhdim.</p>	
<p>Organizimi dhe zhvillimi i aktivitetit sensibilizues për promovimin e Ditës Ndërkombetare të fëmijëve.</p>	<p>Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është realizuar aktiviteti ndërgjegjësues për të Drejtat e Fëmijëve.</p>	<p>Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, shkollat 9 vjecare dhe organizatat partnere të shoqërisë civile ka organizuar aktivitetin social, kulturor, sensibilizues me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve. Ky aktivitet u organizua në lulishten pranë Bexhistenit dhe ishin pjesëmarrës rreth 100 fëmijë.</p>
<p>Organizimi i një sere aktiviteteve të shtrira përgjatë javës në qendrat komunitare për të informuar dhe promovuar të drejtat e grave në jetën sociale, ekonomike, politike, kulturore, etj.</p>	<p>Është planifikuar dhe realizuar një fushatë ndërgjegjësuese e shtrirë përgjatë të gjithë javës e quajtur "java e gruas".</p>	<p>Në kuadër të 8 Marsit, gjatë të gjithë javës janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese me komunitetin, me shoqërinë civile, me institucionet rajonale. Aktivitetet janë zhvilluar në institucionet kulturore, si Muzeu Historik "Oso Kuka", Muzeu i Dëshmisë dhe Kujtesës, Biblioteka "Marin Barleti", etj., në qendrat komunitare "Për Familjen".</p> <p>Synimi i kësaj fushate ka qenë promovimi i rolit të gruas në shoqëri.</p>

Konsolidimi i shërbimeve parandaluese dhe të kujdestarisë familjare me synim parandalimin e institucionalizimit të fëmijëve, deinstitutionalizimi i fëmijëve, identifikimi dhe trajnimi i familjeve të gatshme kujdestare.

Në vazhdim të vitit të tretë të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Marrëveshjen me Save The Children, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuese për shërbimet alternative me qëllim parandalimin e institutionalizimit dhe deinstitutionalizimin e fëmijëve. Po zbatohen aktivitete në mbështetje për familjet biologjike me synim parandalimin e braktisjes dhe rikthimin e fëmijëve, nga kujdesi rezidencial pranë familjeve të tyre.

Gjatë këtij 8 mujori, 28 familje kanë përfituar shërbime parandaluese dhe fuqizuese me synim rritjen e fëmijëve pranë familjeve biologjike.

Realizimi i Marrëveshjes në mes Bashkisë së Shkodrës dhe Shpresë për Botën për vitin 2018 për krijimin dhe ofrimin e mundësive më të mira për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe gjithashtu me synim bashkëpunimin në shërbime të tjera për familjet në nevojë.

Bashkia e Shkodrës ka arritur marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, për mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit.

Në zbatim të marrëveshjes së arritur është përmirësuar cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Në shtëpinë e fëmijës 6 – 18 vjec është inaguruar salla për aktivitete sportive dhe kulturore për fëmijët që jetojnë në këtë institucion dhe jo vetëm. Gjatë këtij 8 mujori janë realizuar 12 aktivitete në bashkëpunim me këtë organizatë.

Ndërgjegjësimi i komunitetit, institucioneve publike dhe organizatave për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të komunitetit rom në jetën, sociale, ekonomike e kulturore.

Në kuadër të kësaj dite, janë organizuar aktivitete ndërgjegjësuese me pjesëmarrje të gjerë nga komuniteti, institucionet dhe organizatat. Synimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë integrimi i komunitetit rom dhe egjiptian.

Në shkollën “Salo Halili” është organizuar aktiviteti ndërgjegjësues, social-kulturor ku morën pjesë përfaqësues nga komuniteti rom, përfaqësues të organizatave partnere ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore. Theksi i këtij aktiviteti ishte edukimi dhe frekuentimi i shkollës për fëmijët rom. Gjithashtu në bibliotekën “Marin Barleti” është zhvilluar një takim me fëmijët rom dhe me shkrintarin për fëmijë Xhahid Bushati, i cili i foli fëmijëve për rëndësinë e librit gjatë të gjithë jetës. U zhvillua një javë aktivitete ku u dhuruan libra dhe



lodra për fëmijët rom.

Zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve" me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për familjet në nevojë në Bashkinë e Shkodrës në kuadër të shtrirjes së shërbimeve komunitare.	Në vazhdim të vitit të dytë të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Marrëveshjen me Sos Fshatrat e Fëmijëve, janë zhvilluar aktivitete edukuese, formuese dhe ndërgjegjësuese me synim fuqizimin e familjes së fëmijëve në rrezik institucionalizimi dhe fëmijëve të institucionalizuar për parandalimin dhe deinstitutionalizimin e tyre.	Gjatë këtij 8 mujori, janë realizuar 5 aktivitete në bashkëpunim me Sos, Fshatrat e Fëmijëve dhe nr i përfituesve është 320.
---	---	--

### Aktivitetet dhe projektet që planifikohen në përmbushje të objektivit F2.O3.

Aktiviteti	Buxheti në mijë lekë	Realizimi 8-mujori i 2018 në mijë lekë
<b>P10.F2.O3. A1. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;</b>	-	Në proces zbatimi
<b>P10.F2.O3. A2. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.</b>	50	Parashikuar në muajin Tetor
<b>P10.F2.O3. A4. Dita ndërkombëtare e të moshuarve</b>	-	Parashikuar në muajin Tetor
<b>P10.F2.O3. A5. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi Ndryshe, më 3 Dhjetor.</b>	100	Parashikuar në muajin Tetor
<b>P10.F2.O3. A6. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qeshor"</b>	-	Realizuar
<b>P10.F2.O3. A7. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi</b>	99	98.1
<b>P10.F2.O3. A8 Bashkëpunimi me Save the Children.</b>	-	Në proces zbatimi
<b>P10.F2.O3. A9 Bashkëpunimi me Fondacionin "Shpresë për botën", për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.</b>	-	Në proces zbatimi
<b>P10.F2.O3. A10: Dita ndërkombëtare e romëve</b>	85.7	85.5
<b>P10.F2.O3. A11. Bashkëpunimi me organizatën "Sos, Fshatrat e Fëmijëve."</b>	-	Në proces zbatimi

**F2.O4. Gjithpërfshirja, Pjesëmarrja, krijimi i Mundësive të Barabarta dhe Mosdiskrimini për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit.**

Situata e synuar 2018 Objektivat	Realizimi i objektivave 8-mujori i 2018	Realizimi i produkteve 8- mujori i 2018
Vazhdimi i aktiviteteve të planifikuara në marreveshje me synim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe gjithashtu krijimin e kushteve	Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP për projektin ESERE "Fuqizimi ekonomik dhe social për romët dhe egjiptianët, një shtysë për	Gjatë këtij 8 mujori ka vazhduar ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë qendrës komunitare multifunksionale, për



më të mira të jetesës për këtë komunitet. Vënia në funksion të plotë e qendrës komunitare për romet dhe egjiptianët. përfshirjen sociale” janë realizuar ndërhyrjet e planifikuara me qëllim fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për këtë komunitet. janë komunitetin rom dhe egjiptian. Është arritur punësimi i 18 personave të komunitetit rom dhe egjiptian dhe janë referuar për përfitim të kurseve profesionale, ku vetëm 5 kanë shfaqur interes dhe po ndjekin kurset. Janë përfunduar 2 procedura për ndarje nga trangu familjar dhe një tjetër aktualisht është në proces. Gjatë kësaj periudhe procesi për ndërtimin e qendrës së multifunktionale është në përfundim. Kjo qendër do ofrojë shërbime specifike për komunitetin rom dhe egjiptian. Numri i përfituesve të shërbimeve gjatë këtij 8 mujori është 300.

Përkujdesje, lehtësim dhe përmirësim të kushteve socio-ekonomike në prag të festave të fundvitit. Parashikuar në muajt në vazhdim.

